

NJOFTIM STATISTIKOR
BORXHI I JASHTËM BRUTO

10 Dhjetor, 2024

BORXHI I JASHTËM BRUTO

Përmbajtja

Borxhi i jashtëm bruto	1
Borxhi i jashtëm bruto sipas sektorëve	3
Borxhi i jashtëm bruto sipas instrumenteve	4
Tërheqjet dhe shërbimet e borxhit të jashtëm bruto	5
Shënime metodologjike	6

Kryesore:

- Borxhi i Jashtëm Bruto (BJB) vlerësohet në 10,003 milionë euro;
- Në terma tremujore, stoku i BJB u ngushtua me 1.1%, kryesisht për rezultat të uljes së borxhit publik;
- Në raport me PBB, Borxhi i Jashtëm Bruto shënon 40.9% në fund të T3 2024 nga 42.6% në fund të T2 2024;
- 88% e vëllimit të BJB është borxh afatgjatë;
- Zhvillimet kryesore, gjatë tremujorit, i përkasin ngushtimit të detyrimeve të Qeverisë së Përgjithshme.


Në fund të muajit Shtator 2024, Borxhi i Jashtëm Bruto (BJB) i Shqipërisë shënon 10,003 milionë euro. Gjatë tremujorit të tretë, stoku i BJB-së u ngushtua me rreth 113 milionë euro (ose -1.1%). Vlera neto e transaksionit rezultoi negative, në ngushtim të tepricës së borxhit me rreth -59 milionë euro. Në të njëjtën kohë, efekti i përlogaritur i kursit të këmbimit të monedhës EUR kundrejt monedhave përbërëse në emërimin e detyrimeve të Shqipërisë ndaj botës dhe ndryshimet e tjera nga ri-klasifikimi vlerësohen, gjithashtu negative, respektivisht në rreth -53.2 milionë euro dhe -1.8 milionë euro.

Në masën 88%, BJB prezantohet në maturitetin afatgjatë. Gjatë tremujorit të tretë 2024, teprica e borxhit të jashtëm afatgjatë u ngushtua me 53 milionë euro, si pasojë e ngushtimit të borxhit publik¹, ndërkohë që, borxhi privat ka zgjeruar detyrimet e tij. Qeveria e Përgjithshme ka ulur detyrimet në formën e huamarrjes me rreth 103 milionë euro, dhe në të njëjtën kohë, ka ulur ekspozimin në letra me vlerë të borxhit me rreth 19 milionë euro. Borxhi privat u zgjerua me rreth 78 milionë euro, kryesisht në drejtim të rritjes së tepricës në “monedha dhe depozita” të jorzidentëve pranë Korporatave Depozituese.

BJB në maturitetin afatshkurtër ra me rreth 61 milionë euro, në nivelin 1,192 milionë euro dhe reflekton kryesisht uljen e detyrimeve afatshkurtra në formën e “kredive tregtare dhe paradhënieve” të Sektorëve të tjerë.

Për Autoritetin Monetar - alokimet e SDR² nga FMN u ulën me 7 milionë euro, kryesisht për efekt të kursit të këmbimit.

Në fund të Shtatorit 2024, Borxhi i Jashtëm Bruto në raport me PBB shënon 40.9% nga 42.6% në fund të muajit qershor 2024 dhe 45.1 në fund të marsit 2024.



Grafik 1: Borxhi i Jashtëm Bruto

Milione EUR	30 shtator 2023	31 dhjetor 2023	31 mars 2024	30 qershor 2024	30 shtator 2024
Borxhi i jashtëm afatgjatë	8,979	8,986	8,982	8,863	8,810
Borxhi publik	5,208	5,148	5,108	4,953	4,830
Borxhi privat	3,547	3,618	3,649	3,684	3,761
Borxhi i bankës qendrore, nga të cilat	224	220	224	226	219
Alokimet SDR nga FMN	224	220	224	226	219
Borxhi i jashtëm afatshkurtër	1,143	1,090	1,310	1,253	1,192
Borxhi i jashtëm bruto	10,121	10,075	10,292	10,116	10,003

Tabela 1: Borxhi i Jashtëm Bruto

1. Borxhi i jashtëm publik përfshin huamarrjen me jashtë drejtpërdrejt nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe qeveritë lokale, huamarrjen me jashtë të garantuar nga MFE dhe qeveritë lokale, në përputhje me legjislacionin mbi borxhin publik, duke përfshirë huatë e marra nga MFE në përputhje me marreveshjen e FMN-së, si dhe letrat me vlerë të qeverisë të blera nga jorzidentët - të llogaritur me vlerën nominale.

2. Alokimi i SDR është një mënyrë për të plotësuar rezervat valutore të vendeve anëtare të Fondit, duke i lejuar anëtarët të zvogëlojnë varësinë e tyre në borxhin e brendshëm ose të jashtëm për ndërtimin e rezervave. Shqipëria ka përfituar nga alokimi i SDR nga viti 2009.

Monedha evropiane (EUR) është monedha kryesore në emërimin e detyrimeve të Shqipërisë ndaj botës, në rreth 71% të totalit, e ndjekur nga USD me 9% dhe SDR me 7%.

	Borxhi jashtëm	
	Milionë EUR	%
EUR	7,116	71%
USD	894	9%
SDR	706	7%
CAD	129	1%
JPY	42	0%
Të tjera	1,117	11%
Totali	10,003	100%

Tabela 2: Kompozimi sipas monedhave i borxhit të jashtëm bruto, në 30 shtator 2024

Kreditorët publikë mbajnë pjesën më të madhe (39%) të tepicës së borxhit të jashtëm afatgjatë. Zotërimet e bankave të huaja në Eurobondin qeveritar shënojnë rreth 15% të BJB-së afatgjatë. Kreditorët privatë në fund të muajit Shtator 2024 mbajnë rreth 15% të tepicës së BJB-së në maturitetin afatgjatë. Detyrimi afatgjatë mes kompanive të lidhura në një marrëdhënie investimi direkt (përfshirë në zërin “Të tjera” në tabelën 3), mbajnë një nivel prej rreth 16% të totalit të borxhit të jashtëm gjatë dhe në fund të Shtatorit 2024 shënon 1,414 milionë euro.

Monedha evropiane (EUR) është monedha kryesore në emërimin e detyrimeve të Shqipërisë ndaj botës

	31 mars 2024		30 qershor 2024		30 shtator 2024	
	Milionë EUR	%	Milionë EUR	%	Milionë EUR	%
Hua nga institucionet financiare ndërkombëtare	3,569	40%	3,503	40%	3,420	39%
Investime portofoli të bankave private dhe të qeverisë	1,390	15%	1,318	15%	1,299	15%
Hua nga banka private dhe institucione të tjera financiare	1,323	15%	1,313	15%	1,352	15%
Të tjera	2,700	30%	2,729	31%	2,740	31%
Borxhi i jashtëm afatgjatë	8,982	100%	8,863	100%	8,810	100%

Tabela 3: Borxhi i jashtëm afatgjatë sipas kreditorëve

Pjesa e borxhit të jashtëm me maturitet më të gjatë se 5 vjet kalon dukshëm borxhin me maturitet nga 1 dhe 5 vjet (Tabela 4). Në maturitetin 1-5 vjet dominon borxhi privat, ndërsa në atë mbi 5 vjet dominon borxhi publik.

	31 mars 2024		30 qershor 2024		30 shtator 2024	
	Milionë EUR	%	Milionë EUR	%	Milionë EUR	%
1-5 vjet	2,027	23%	2,043	23%	2,123	24%
Borxhi publik						
Borxhi privat	2,027	23%	2,043	23%	2,123	24%
me shume se 5 vjet	6,954	77%	6,820	77%	6,687	76%
Borxhi publik	5,333	59%	5,177	58%	5,049	57%
Borxhi privat	1,622	18%	1,641	19%	1,638	19%
Borxhi i jashtëm afatgjatë	8,982	100%	8,863	100%	8,810	100%

Tabela 4: Borxhi i jashtëm afatgjatë sipas maturitetit



BORXHI I JASHTËM BRUTO SIPAS SEKTORËVE INSTITUCIONALË

Qeveria e Përgjithshme zotëron rreth 46.2% të totalit të Borxhit të Jashtëm Bruto të Shqipërisë. Pjesa tjetër është e shpërndarë midis Sektorëve të Tjerë (31.6%), Sistemit Bankar (20.1%) dhe Autoritetit Monetar (2.2%).

Në fund të muajit Shtator 2024, detyrimet e Qeverisë së Përgjithshme vlerësohen në 4,616 milionë euro dhe prezantohen vetëm në instrumente afatgjatë, të tilla si “hua” dhe “obligacione dhe dëftesa”.

Referuar fundit të T2 2024, teprica e borxhit të jashtëm të Qeverisë së Përgjithshme vlerësohet e ngushtuar me rreth 123 milionë euro. Gjatë tremujorit, detyrimet e borxhit në formën e huave afatgjata dhe ato në formën e obligacioneve ranë përkatësisht me -103 milionë euro dhe -19 milionë euro.

Huatë e Qeverisë së Përgjithshme përfaqësohen nga huatë e tërhequra pas viteve '90 dhe ato të riskeduluara, të cilat vazhdojnë të jenë të negociueshme midis palëve. Në fund të periudhës, huatë e riskeduluara kanë rënë nën 0.1% të stokut të huave afatgjata të këtij sektori.

Teprica e detyrimit të Autoritetit Monetar ose Bankës Qendrore, shënon 219 milionë euro, me ulje 7 milionë euro, kryesisht për efekt të kursit të këmbimit. Detyrimet e Autoritetit Monetar përbëhen vetëm nga alokimet në SDR të FMN-së, në vlerën 219 milionë euro.

Në fund të Shtator 2024, borxhi i jashtëm bruto i Korporatave Depozituese shënon 2,008 milionë euro, në rritje me rreth +59 milionë euro referuar fundit të T2 2023. Në masën më të madhe, teprica e detyrimeve të këtij sektori prezantohet në maturitetin afatgjatë në formën e “monedha e depozita” (në rreth 74% të totalit).

Gjatë tremujorit të tretë 2024, borxhi i jashtëm i Sektorëve të Tjerë u ngushtua me 42 milionë euro në nivelin 3,159 milionë euro. Lëvizjet kryesore reflektojnë efektin e agreguar të rënies së detyrimeve të borxhit mes kompanive të lidhura në një marrëdhënie investimi direkt “investime direkte - hua ndërkompani” (-10 milionë euro), si dhe rënies së detyrimeve në formën e “kredi tregtare dhe paradhënie” (-32 milionë euro).

Korporatat depozituese shënuan zgjerimin më të madh të detyrimeve, të prezantuara në formën e zgjerimit të depozitave të jorezidentëve në këtë sektor

	31 mars 2024		30 qershor 2024		30 shtator 2024	
	Milionë EUR	%	Milionë EUR	%	Milionë EUR	%
Qeveria e përgjithshme	4,876	54%	4,739	53%	4,616	52%
Autoriteti monetar	224	2%	226	3%	219	2%
Korporata depozituese pënjështuar bankën qendrore	1,533	17%	1,542	17%	1,622	18%
Sektorë të tjerë, nga të cilat	2,348	26%	2,356	27%	2,353	27%
Korporata jofinanciare	752	8%	729	8%	726	8%
Korporata jofinanciare në marrëdhënie investimi direkt	1,399	16%	1,417	16%	1,414	16%
Borxhi i jashtëm afatgjatë	8,982	100%	8,863	100%	8,810	100%

Tabela 5: Borxhi i jashtëm afatgjatë sipas sektorëve institucionalë

	31 mars 2024		30 qershor 2024		30 shtator 2024	
	Milionë EUR	%	Milionë EUR	%	Milionë EUR	%
Qeveria e përgjithshme						
Autoriteti monetar						
Korporata depozituese pënjështuar bankën qendrore	481	37%	407	33%	386	32%
Sektorë të tjerë, nga të cilat	830	63%	845	67%	807	68%
Korporata jofinanciare	601	46%	619	49%	587	49%
Korporata jofinanciare në marrëdhënie investimi direkt	221	17%	221	18%	214	18%
Borxhi i jashtëm afatshkurtër	1,310	100%	1,253	100%	1,192	100%

Tabela 6: Borxhi i jashtëm afatshkurtër sipas sektorëve institucionalë



BORXHI I JASHTËM BRUTO SIPAS INSTRUMENTAVE

Kompozimi i borxhit të jashtëm afatgjatë sipas instrumenteve (Tabela 7), tregon ngushtim të konsiderueshëm të tepricës në “hua” dhe rritje të ekspozimit në “letra me vlerë të borxhit”. Si mjet financimi afatgjatë, huatë vijojnë të kryesojnë detyrimet afatgjata - në masën 47% të totalit.

Në maturitetin afatshkurtër, instrumentet financiarë në formën e “investimeve direkte”, si dhe “kreditë tregtare dhe paradhënie” zënë përkatësisht 18% dhe 49% të tepricës së borxhit afatshkurtër.

	31 mars 2024		30 qershor 2024		30 shtator 2024	
	Milionë EUR	%	Milionë EUR	%	Milionë EUR	%
Investim e direkte	1,399	16%	1,417	16%	1,414	16%
Hua	4,349	48%	4,263	48%	4,177	47%
Kredi tregtare dhe paradhënie						
Monedha dhe depozita	1,397	16%	1,415	16%	1,477	17%
Letrat me vlerë të borxhit	1,613	18%	1,542	17%	1,523	17%
Alokimi i SDR	224	2%	226	3%	219	2%
Llogari të tjera të pagueshme	0	0%	0	0%	0	0%
Borxhi i jashtëm afatgjatë	8,982	100%	8,863	100%	8,810	100%

Tabela 7: Borxhi i jashtëm afatgjatë sipas instrumenteve

	31 mars 2024		30 qershor 2024		30 shtator 2024	
	Milionë EUR	%	Milionë EUR	%	Milionë EUR	%
Investim e direkte	221	17%	221	18%	214	18%
Hua	79	6%	44	3%	54	5%
Kredi tregtare dhe paradhënie	601	46%	619	49%	587	49%
Monedha dhe depozita	392	30%	351	28%	320	27%
Letrat me vlerë të borxhit						
Alokimi i SDR						
Llogari të tjera të pagueshme	17	1%	18	1%	17	1%
Borxhi i jashtëm afatshkurtër	1,310	100%	1,253	100%	1,192	100%

Tabela 8: Borxhi i jashtëm afatshkurtër sipas instrumenteve

Ecuria e BJB-së sipas instrumenteve shfaq dominim të konsiderueshëm të tepricës në “hua”



TERHEQJET DHE SHËRBIMI I BORXHIT TË JASHTËM BRUTO

Gjatë tremujorit të tretë 2024, totali i të hyrave (tërheqjeve) ose fluksi i borxhit të ri, të gjeneruar nga aktiviteti huamarrës, shënon 125 milionë euro (Tabela 9), nga të cilat 94 milionë euro i takojnë sektorit privat.

Shërbimi i borxhit të jashtëm (pagesat e principalit dhe të interesit) për periudhën, shënon 167 milionë euro. Në masën 78%, shërbimi i borxhit ka qenë për shlyerje të kryegjësë (principalit) dhe në 22% për shlyerjen e interesave.


Gjatë periudhës, shlyerjet me rreth 121 milionë euro janë pagesa të Qeverisë së Përgjithshme 34 milionë euro të Sektorëve të Tjerë dhe 12 milionë euro të Korporatave Depozituese.

Sektori publik mban peshën kryesore në shlyerjet e principalit me rreth 69% të vlerës së përgjithshme të transaksionit, si dhe në shlyerjen e pagesave të interesit, me rreth 31 milionë euro ose 85% të vlerës së përgjithshme të interesave të paguara nga ekonomia.

	Milionë Euro			
	T4 2023	T1 2024	T2 2024	T3 2024
1. Sektori publik				
Tërheqje	236	83	27	31
Pagesa principalit	116	98	119	99
Pagesa interesi	26	32	30	32
2. Sektori privat				
Tërheqje	130	27	53	94
Pagesa principalit	57	30	49	32
Pagesa interesi	6	7	7	5
Ekonomia				
Tërheqje	367	111	79	125
Pagesa principalit	172	128	168	130
Pagesa interesi	32	39	37	36

Qeveria e Përgjithshme mban peshën kryesore në shlyerjen e pagesave të principalit dhe interesit për periudhën

Tabela 9: Tërheqjet dhe shërbimi i borxhit nga sektori publik dhe sektori privat



Grafik 2: Shërbimi i borxhit të jashtëm bruto ndaj eksportit të mallrave dhe shërbimeve



SHËNIME SHPJEGUESE

<p>Hyrje</p>	<p>Të dhënat e paraqitura i përkasin stokut të fundit të periudhës të detyrimeve të huaja financiare të ekonomisë shqiptare. Të dhënat janë kompiluar në bazë bruto: d.m.th ato nuk iu përkasin zotërimeve të rezidentëve të Shqipërisë në mjete të huaja, gjë që është thelbësore. Ashtu si statistikave të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare dhe statistikave të Borxhit të Jashtëm bëjnë dallimin ndërmjet investimeve direkte, investimeve të portofolit dhe investimeve të tjera dhe përsërisin në një detajim më të gjërë anën e detyrimeve të paraqitjes vjetore të PIN-t. Si e tillë, tabela e Borxhit të Jashtëm identifikon atë element të bilancit të agreguar të Shqipërisë që tregon detyrimet financiare bruto (detyrimet) të rezidentëve të Shqipërisë ndaj jo-rezidentëve me përjashtim të titujve të kapitalit dhe derivativëve. Shifrat prezantohen në mënyrë që të kenë qëndrueshmëri me formatet e prezantimit ndërkombëtar. Informacioni është bërë i disponueshëm për Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore (https://data.worldbank.org/country/albania).</p>
<p>Standarte Statistike Ndërkombëtare</p>	<p>Statistikat e Borxhit të Jashtëm janë kompiluar në përputhje me standardet ndërkombëtare, të përshkruara në “Manuali i Statistikave të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare, Edicioni i Gjashtë” (FMN) dhe me udhëzuesin për kompilues e përdorues “Statistikat e Borxhit të Jashtëm” (FMN). Ndjekja e këtyre standardeve siguron pajtueshmëri të të dhënave nga njëra anë dhe nga ana tjetër, konsistencë midis statistikave të borxhit e atyre të bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare. Të dhënat mbi borxhin e jashtëm bruto janë një burim i rëndësishëm informacioni për zëra të caktuar të këtyre statistikave (shiko më poshtë përkufizimin e <i>borxhit të jashtëm</i>).</p>
<p>Përkufizimi i Borxhit të Jashtëm</p>	<p>Guida e Borxhit të Jashtëm të FMN-së e përkufizon borxhin e jashtëm si një pikë në kohë në pasqyrën financiare të vlerës dhe përbërjes së stokut të detyrimeve financiare bruto të një ekonomie ndaj pjesës tjetër të botës. Detyrimet të cilave ju referohemi mbulojnë kreditë e marra nga jo-rezidentët, llogaritë dhe depozitat e jo-rezidentëve, kreditë tregtare që duhet tu paguajmë jo-rezidentëve si dhe detyrime të tjera ndaj tyre. Në thelb, borxhi i jashtëm iu referohet detyrimeve financiare ndaj jo-rezidentëve dhe jo atyre që rezultojnë nga transaksionet në kapital ose nga kontratat e derivativëve financiarë.</p>
<p>Rezidenca</p>	<p>Termi <i>rezident</i> iu dedikohet (a) individëve, përfshirë dhe atyre me kombësi të huaj, që jetojnë në Shqipëri për të paktën një vit ashtu si dhe stafit të ambasadës shqiptare dhe stafit ushtarak të vendosur jashtë, (b) trupave qeveritare shqiptare të vendosura jashtë (ambasadave, konsullatave, etj), dhe (c) korporatave që kanë në Shqipëri qendrën e interesit ekonomik, përfshirë dhe degët e kompanive të huaja të regjistruara. Gjithashtu përfshihen edhe sipërmarrjet me pronësi të huaj të vendosura në Shqipëri dhe të angazhuara në aktivitete të shërbimeve financiare të tregtuara në arenën ndërkombëtare.</p> <p><i>Jorezidentë</i> të një ekonomie përkufizohen njësitë institucionale që nuk janë rezidentë të asaj ekonomie.</p>
<p>Tipet e Instrumentave Financiarë të Rëndësishëm për Borxhin e Jashtëm</p>	<p><i>Kapitali</i>: ndërkohë që, detyrimet e lindura nga pjesëmarrja me fuqi votuese në kapital (përfshirë këtu detyrimet që lindin nga emetimi i pjesëmarrjeve në institucione kolektive investimi) përjashtohen nga statistikave të borxhit të jashtëm, detyrimet që lindin si pasojë e emetimit të aksioneve preferenciale jo-pjesëmarrëse përfshihen dhe trajtohen si tituj borxhi nën zërin (afatgjatë) <i>obligacione dhe tituj</i>.</p> <p><i>Obligacionet dhe titujt</i> e emetuar nga kompanitë ose qeveria janë tituj borxhi të tregtueshëm që kanë një maturitet fillestar prej më shumë se një vit, i cili, zakonisht, i jep mbajtësit (i) të drejtën e pakushtëzuar të një e ardhur monetare fikse ose të një e ardhur variable të përcaktuar kontraktualisht dhe (ii) të drejtën e pakushtëzuar të një shumë fikse në pagesat e principalit në një datë ose data specifike.</p> <p><i>Instrumentet e tregut të parasë</i> janë tituj borxhi të emetuar me një maturitet fillestar prej një viti ose më pak. Ata i japin mbajtësit të drejtën e pakushtëzuar për të marrë një shumë parash të deklaruar dhe fikse në një datë specifike. Këta instrumenta janë, përgjithësisht të tregtueshëm me skonto në tregje të organizuara. Skontoja është e varur nga norma e interesit të instrumentit të lidhur me normën e interesit të tregut dhe kohën e mbetur deri në maturim. Shembuj të instrumenteve të tillë janë: bonot e thesarit, letrat tregtare dhe financiare dhe pranimet bankare.</p>

	<p><i>Kreditë tregtare</i> (të pagueshme) janë detyrime që lindin nga zgjerimi direkt i kredisë i lidhur me transaksione në mallra dhe shërbime dhe pagesa në avancë për punën në progres (ose që duhet ndërmarrë).</p> <p><i>Huatë/monedhat dhe depozitat</i> përfshijnë huatë, depozitat dhe monedhat (si p.sh, kart-monedhat dhe monedhat që janë në qarkullim dhe të përdorura gjerësisht për të kryer pagesa). Të përfshira janë huatë për të financuar tregtinë, hua të tjera dhe paradhënie (përfshirë dhe kredinë për shtëpi) ashtu si dhe lizingu financiar.</p> <p>Stoku i detyrimeve i gjithë instrumenteve të tjerë financiarë (ndryshe nga kapitale jo-pjesëmarrëse - pa fuqi votuese, tituj të borxhit, kredi tregtare, hua, monedha dhe depozitave), të tillë si kapitali i nënshkruar për pjesëmarrje nga Shtete Anëtare në organizatat ndërkombëtare jo-monetare, ndryshimet në rezervat teknike të sigurimit, kompensimet për sa iu përket transaksioneve të titujve të papaguar, përfshihen në <i>detyrime të tjera</i> brenda borxhit të jashtëm.</p>
Mbledhja e të dhënave	Burim informacioni për statistikën e Borxhit të Jashtëm janë: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Organizata e Institucione të tjera Ndërkombëtare si dhe sistemi bankat pjesë e Sistemit të Unifikuar të Raportimit në Bankën e Shqipërisë.
Vlerësimi	Stoku i detyrimeve është regjistruar në vlerë nominale dhe jo në vlerë tregu dhe Borxhi i Jashtëm Bruto i Shqipërisë është kompiluar në lekë dhe raportuar në euro. Për stokun e detyrimeve në monedha të tjera, konvertimi bëhet me kursin zyrtar të këmbimit të datës së fundit të periudhës së raportimit. Efekti i ndryshimit të kurseve të këmbimit është përfshirë në vlerësimin e stokut të detyrimeve. Instrumentet përkatës përfshijnë dhe interesat e përlogaritur në vlerën e stokut të tyre.
Paraqitja e tabelës	<p>Paraqitja e të dhënave të borxhit të jashtëm së pari dallon sektorët institucionalë:</p> <p><i>Qeveria e Përgjithshme</i> – mbulon qeverinë qendrore</p> <p><i>Autoriteti Monetar</i> – është Banka Qendrore e Shqipërisë</p> <p><i>Korporatat depozituese me përjashtim të Bankës Qendrore</i> – janë bankat e licensuara</p> <p><i>Sektorët e Tjerë</i> – janë të gjitha korporatat e tjera dhe si dhe ekonomitë familjare. Të përfshira këtu janë: kompanitë e sigurimeve dhe fondet e pensionit, fondet e investimit, shoqëritë e kursim kreditit, tregtarët e titujve, ashtu si dhe kompanitë e shërbimeve jo-financiare dhe të prodhimit dhe sipërmarrje të tjera industriale.</p> <p>Kategoria e <i>investimeve direkte</i> dallohet, gjithashtu, në këtë nivel. <i>Investimi direkt</i> është një kategori e investimit ndërkombëtar që, bazuar në një pronësi kapitali në të paktën 10%, reflekton një interes të qëndrueshëm të një rezidenti në një ekonomi (investitori direkt) në një sipërmarrje rezidente në një ekonomi tjetër (kompania e investimit direkt). <i>Detyrimet e borxhit ndaj sipërmarrjeve të lidhura dhe detyrimet e borxhit ndaj investitoreve direkte</i> mbulojnë të gjitha detyrimet e borxhit (siç janë përcaktuar më sipër) të kompanive rezidente ndaj mëmave të tyre të huaja, degëve ose sipërmarrjeve të tjera të lidhura jashtë.</p> <p>Brenda sektorëve klasifikimet jepen sipas:</p> <p><i>maturitetit - afat-shkurtër</i>: në rastet e një maturimi origjinal një vit ose më pak;</p> <p><i>afat-gjatë</i>: për një maturim origjinal më shumë se një vit; dhe sipas,</p> <p><i>instrumentit financiar</i>: monedha dhe depozita, <i>tituj borxhi</i>, <i>kredi tregtare (të pagueshme)</i>, <i>detyrime të tjera borxhi dhe alokimet në SDR</i>.</p>

**DEPARTAMENTI I
STATISTIKAVE
FINANCIARE**

Selia Qendrore Nr. 1 e Bankës së
Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1,
Tiranë

Tel: + 355 4 241 93 01
+ 355 4 241 93 02
+ 355 4 241 93 03
+ 355 4 241 94 09
+ 355 4 241 94 10
+ 355 4 241 94 11

Fax: + 355 4 241 94 08
Email: statistics@bankofalbania.org



Shënime:

Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën për të bërë rishikimin e statistikave të publikuara. Në rastin e rishikimeve që sjellin ndryshime të treguesve, Banka e Shqipërisë njeh përdoruesit me faktorët e rishikimit dhe ndikimin përkatës.

Gjatë periudhës kanë ndodhur ndryshime në stokun e borxhit të jashtëm bruto si pasojë e rishikimeve të informacionit me të dhëna nga njësitë raportuese.

Për më shumë informacion referojuni të dhënave në linkun:

*[https://www.bankofalbania.org/Statistikat/Statistikat_e_Sektorit_te_Jashtem/
Borxhi_i_Jashtem_Bruto/Borxhi_i_Jashtem_Bruto.html](https://www.bankofalbania.org/Statistikat/Statistikat_e_Sektorit_te_Jashtem/Borxhi_i_Jashtem_Bruto/Borxhi_i_Jashtem_Bruto.html)*